FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

ATROPINE

Tretësirë me pika për sy – 1%
(Atropinë sulfat)

Lexojeni me kujdes të gjithë këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e këtij bari sepse përmban informacione të rëndësishme për ju.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar vetëm për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se keni efekte anësore, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin edhe efekte anësore që nuk janë të renditura në këtë fletudhëzues. Shikoni pikën 4.

Çfarë ka në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Atropine dhe përse përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni Atropine
3. Si ta përdorni Atropine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Atropine
6. Informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË ATROPINE DHE PËRSE PËRDORET
Atropina bën pjesë në një grup barnash të quajtura barna antimuskarinikë. Këto barna shkaktojnë midriazë (zgjerim të bebes së syrit) dhe ciklopleqji (relaksim të muskujve që bëjnë të mundur fokusimin e syrit).
Atropine përdoret për trajtimin e inflamacionit në sy (iritit dhe uveitit) dhe para disa ekzaminimeve të syve.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË PËRDORNI ATROPINE
Mos përdorni Atropine në qoftë se:
- jeni i mbindjeshëm (alergjik) ndaj atropinës ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të barit, pasi mund të shfaqen reaksione alergjie, përfshirë anafilaksinë;
- vuani nga glaukoma me kënd të ngushtë ose forma të tjera të glaukomës;
- vuani nga miastenia gravis.

Duhet të shmangni përdorimin e Atropine tek fëmijët, veçanërisht në fëmijët që kanë dëmtime të trurit, paralizë spastike ose vuajnë nga sindroma Down.

Paralajmërime dhe masa paraprake
Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj para se të përdorni këtë bar në qoftë se:
- zakonisht vendosni lente kontakti, sepse atropina i than sytë dhe vështirëson mbajtjen e lenteve të kontaktit; nuk duhet të vendosni lentet e buta të kontaktit ndërkohë që përdorni këtë bar (shiko pikën "Informacion i rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse të Atropine");
- jeni shtatzënë, doni të mbeteni shtatzënë ose po ushqeni fëmijën me gji;
- keni temperaturë të lartë (ethe);
- keni sy me ngjyrë të errët, sepse në këto raste është më e vështirë të zgjerohet bebja e syrit (duhet të tregoni kujdes në mënyrë që të shmangni hedhjen e tepërt të pikave në sy);
- vuani nga ndonjë problem në zemër, si rrahje të shpejta të saj (takikardi).

Në qoftë se moti është tepër i ngrohtë, konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj para se të përdorni këtë bar. Përdoreni me kujdes Atropine tek të moshuarit, sepse ata mund të jenë më të ndjeshëm ndaj efekteve anësore të këtij bari.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur, keni marrë / përdorur së fundmi ose mund të merrni / përdorni barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Ndërveprimet klinikisht të rëndësishme me barnat e tjera, vërehen pas përthithjes sistemike të atropinës. Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke u trajtuar me:
- antimuskarinikë të tjerë (si p.sh. bromfeniraminë, klorfeniraminë, klemastinë, dimenhidrinat, prometazinë, tioridazinë, amitriptilinë, klomipraminë, amoksapinë, klozapinë, dizopiramid), të cilët rrisin veprimet M-kolinolitike të atropinës;
- barna kolinomimetike dhe frenues të kolinesterazës, të cilat antagonizojnë efektet e atropinës.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut tuaj përpara se ta përdorni këtë bar.

Shtatzënia
Atropina e kalon placentën, por nuk dihet që të jetë e dëmshme. Megjithatë rekomandohet të shmanget përdorimi i saj në shtatzëni. (Kategoria C)

Ushqyerja me gji
Edhe pse atropina kalon në sasi të vogla në qumështin e gjirit, rekomandohet të shmanget përdorimi i saj gjatë ushqyerjes me gji.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Ky bar mund të shkaktojë efekte anësore të tilla si: turbullimi i shikimit, marrje mendsh dhe efekte të tjera që ndikojnë në aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin ose përdorur makineri. Prandaj gjatë trajtimit me Atropine duhet të evitoni përdorimin e automjeteve dhe makinerive.

Informacion i rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse të Atropine
Ky bar përmban 1 mg klorur benzalkoni / flakon 10 ml. Kloruri i benzalkonit mund të përthithet nga lentet e buta të kontaktit dhe mund të ndryshojë ngjyrën e tyre. Ju duhet t'i hiqni lentet përpara se ta përdorni këtë bar dhe t'i vendosni përsëri pas 15 minutash.
Kloruri i benzalkonit mund të shkaktojë irritim të syrit, sidomos në qoftë se keni sy të thatë ose çrregullime të kornesë (shtresa transparente e përparme e syrit). Në qoftë se keni ndjesi jonormale të syrit, djegie ose dhimbje pas përdorimit të këtij bari, njoftoni mjekun tuaj.

3. SI TA PËRDORNI ATROPINE
Gjithmonë përdoreni Atropine ekzaktësisht si jua përshkruan mjeku juaj. Konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt.

Në irit dhe uveit:
Tek të rriturit: 1-2 pika tretësirë 1% në sy, 2 – 3 herë në ditë.

Për prodhimin e midriazës dhe ciklopleqjisë:
Tek të rriturit: 1 pikë tretësirë 1% në sy, 1 orë para procedurës.

Duhet të shmangni përdorimin e Atropine tek fëmijët, veçanërisht në fëmijët që kanë dëmtime të trurit, paralizë spastike ose vuajnë nga sindroma Down.

Mënyra e administrimit të Atropine – tretësirë me pika për sy 1%, është:
- Lajini mirë duart.
- Mos e prekni vendin e daljes së pikave.
- Shikoni lart.
- Ulni kapakun e poshtëm të syrit për të krijuar një ulluk.
- Vendosni pjesën e sipërme të shishes plastike sa më afër ullukut, por pa e prekur atë.
- Hidhni sasinë e duhur të pikave në ulluk.
- Mbyllni syrin për rreth 2 minuta.
- Tretësira e tepërt që del mund të hiqet me një garzë sterile.

Pikat në sy mund të shkaktojnë një ndjesi djegieje, por kjo ndjenjë nuk zgjat më shumë se disa minuta. Në të kundërt konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Atropine
Në qoftë se keni përdorur më shumë Atropine se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se një fëmijë e ka përdorur gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni menjëherë mjekun tuaj, spitalin, ose urgjencën më të afërt për të marrë një mendim mbi rrezikun dhe këshilla për veprimet që duhet të ndërmerren.
Rrallë ndodhin efekte anësore nga mbidozimi me Atropine – tretësirë me pika për sy.
Megjithatë, efektet anësore që mund të ndodhin si pasojë e mbidozimit me Atropine përfshijnë: efekte antikolinergjike, çrregullime kardiovaskulare (takikardi, aritmi atriale, çrregullime atrio-ventrikulare) dhe çrregullime në sistemin nervor qendror (konfuzion, shqetësime, nervozizëm, haluçinacione dhe konvulsione).

Në qoftë se harroni të përdorni Atropine
Në qoftë se harroni një dozë Atropine, përdoreni atë sa më shpejt. Në qoftë se është pothuajse koha për dozën tjetër, përdoreni atë dhe kalojeni dozën e humbur. Mos përdorni dozë ekstra Atropine për të plotësuar dozën e humbur.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat e tjera, Atropine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokujt i shfaqen.
Si efekte anësore të mundshme përfshihen:
- reaksion alergjik, simptomat e të cilit përfshijnë: skuqje të lëkurës dhe enjtje, lotim apo skuqje të syrit (sy rozë, konjunktivit); në qoftë se ju shfaqen këto efekte anësore, duhet të ndaloni së përdoruri këtë bar dhe të flisni me mjekun ose farmacistin tuaj;
- zgjerim i pupilës së syrit (midriazë), çrregullim i pamjes, paralizë e akomodimit d.m.th. ciklopleqji dhe rritje e tensionit intraokular;
- dermatit kontakti dhe dermatit ekzematoid;
- gojë e thatë, vështirësi në përtypje dhe në të folur, etje, pakësim i lëngjeve në mushkëri;
- rrahje të ngadalta të zemrës (bradikardi) që ndiqen nga rrahje të forta të zemrës (takikardi);
- palpitacione;
- gjithashtu temperaturë e lartë, skuqje dhe tharje e lëkurës, urtikarie, nauze dhe të vjella, konfuzion, lodhje, drobitje, përgjumje, haluçinacione, aritmi etj.

Lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj nëse ju shfaqen këto efekte anësore ose çdo efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletudhëzues.

5. SI TA RUANI ATROPINE
Ruajeni barin larg fëmijëve.
Mos e përdorni Atropine pas datës së skadimit që është e shënuar në paketim.
Ruajeni në një vend të thatë, nën 25°C.
Mos e ruani në ngrirje.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACIONE TË MËTEJSHME
Çfarë përmban Atropine
Lënda aktive është atropinë sulfat.
1 ml tretësirë përmban 10 mg atropinë sulfat.
Lëndët ndihmëse janë: klorur benzalkoni dhe ujë për injeksion.

Përmbajtja e Paketimit
Kuti kartoni që përmban një shishe plastike sterile me 10 ml tretësirë.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.